



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 351/1 Prot.

Tiranë, më 22.02.2021

V E N D I M

Nr. 33, Datë 22.02.2021

Mbështetur në Ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 85, datë 30.07.2020, e D.P kundër Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “Universiteti Marin Barleti”, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjinisë”, “gjendjes ekonomike”, “gjendjes arsimore”, “gjendjes shoqërore” dhe shqetësim psikologjik e moral.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, nga ankuesja në formularin e ankesës dhe me shkresën datë 10.08.2020, protokolluar tek Komisioneri me nr. 1151, datë 12.08.2020, në mes të tjerash informon se: *“Lidhur me trajtimin e pabarabartë për shkak të gjendjes ekonomike, ankuesja shprehet se ka qenë e ngarkuar me shumë detyra administrative dhe një ngarkesë më të madhe mësimore në krahasim me kolegët e saj të Departamentit të Drejtësisë, fakultetit por dhe me kolegët e saj që kanë gradën PhD¹. Në nenin 16.2 të kontratës së saj të punës janë përcaktuar dhe shpërblime në politikat e institucionit, në momentin që punëmarrësi tejkalon ngarkesën, gjë të cilën e ka kërkuar nëpërmjet e-mail-it datë 26.06.2020, por që nuk ka marrë përgjigje nga organet dhe personat kompetentë të institucionit. Ankuesja shprehet se mosrespektimi i kushteve të kontratës së punës ka ndikuar në gjendjen e saj shoqërore dhe sociale. Situata diskriminuese lidhet me faktin se me Urdhrin e Brendshëm të Rektorit, nr. 111, datë 20.12.2019 është emëruar*

¹ Doctor of Philosophy.

si koordinatorë e programeve me karakter profesional dhe si koordinatorë e drejtësisë, duke pasur dy detyra administrative, në krahasim me kolegët e tjerë, të cilët kanë vetëm një detyrë. Kjo ka ndikuar në gjendjen e saj shoqërore dhe sociale si pjesë e Universitetit Marin Barleti, si pjesë e stafit dhe me një mbingarkesë pune në krahasim me kolegët e tjerë. Gjithashtu, urdhri i rektorit bie ndesh me kontratën e punës dhe me ligjin e arsimit të lartë, ku nuk mundet që një pedagog të kryejë punë akademike dhe administrative në të njëjtën kohë. Lidhur me trajtimin e pabarabartë për shkak të gjendjes arsimore, ankuesja shprehet se si në të gjitha universitetet jopublike në Shqipëri, kur ato universitete kanë për të akredituar programin, punësojnë staf me grada dhe tituj dhe më pas kur marrin akreditimin, lëndët i japin pedagogë me titull MSc², pavarësisht formimit dhe profilizimit të pedagogëve. Lidhur me këtë, në programin 3-vjeçar në drejtësi, vitin e kaluar i është përdorur emri duke qenë titullare e disa syllabuseve për në ministri, dhe më pas këto lëndë i janë dhënë që ti zhvillojnë, kolegë të departamentit të drejtësisë dhe departamenteve të tjera me MSc, si psh lëndët: E drejta e punës; Histori e institucioneve politiko-juridike; E drejta familjare; E drejta financiare; Shkrimi dhe arsyetimi ligjor. Ankuesja shprehet se nuk paguhet njësoj si kolegët meshkuj që kanë gradën shkencore PhD, nuk shpërblehet për orët shtesë apo shpërblime të tjera. Lidhur me shqetësimin psikologjik dhe moral, ankuesja informon se, në datë 24.06.2020 është njoftuar me telefon për një takim me sekretaren e përgjithshme dhe administratorin e deleguar. Në këtë takim informal i është bërë presion që të japë dorëheqjen, fillimisht me pretekstin e ristrukturimit dhe më pas që nuk e do pronari, në të kundërt nuk do i jepnin një referencë të mirë, apo do i gjenin prova kundër saj që ta hiqnin nga puna. Për një rast tjetër, ankuesja informon se ditën e shtunë, në javën e madhe të Pashkës, me e-mail është njoftuar nga Rektori që nuk do të ishte më koordinatorë e departamentit të drejtësisë. Ky veprim arbitrar ndaj saj ishte marrë pa e informuar apo konsultuar me ankuesen e cila ishte ndjerë e dobët dhe pa vlerë në një botë akademike, në të cilën vendimet merren pa asnjë procedurë. Për të gjithë situatën e përshkruar sa më sipër, ankuesja informon se në datë 01.07.2020 ka dërguar kërkesën e saj për dorëheqje nga puna”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe kompensimin nga ana e Universitetit Marin Barleti për dëmin pasuror dhe jopasuror, në masën e 7 pagave.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në datën 18.11.2020, kanë hyrë në fuqi ndryshimet ligjore të miratuara me Ligjin nr. 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”³. Meqënëse çështja objekt i këtij shqyrtimi administrativ është paraqitur përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 124/2020, atëherë Komisioneri vlerëson se çështja duhet të shqyrtohet sipas parashikimeve të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të pandryshuar.

² Master of Science.

³ Ligji nr.124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2020 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, është botuar në Fletoren Zyrtare Nr.191, datë 03.11.2020.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së⁴, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas shqyrtimit paraprak, u konstatua se ankesa e depozituar pranë Komisionerit kishte mangësi të anës formale, lidhur me shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit ankues, në lidhje me shkakun e pretenduar dhe lidhjes shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur.

- Për këtë arsye, me shkresat nr. 1116/1, datë 05.08.2020 dhe 1116/2, datë 07.08.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar subjektit ankues të paraqesë shpjegime, lidhur me:
 - Shpjegime të trajtimit të pabarabartë në raport me pedagogët e tjerë për shkak të gjendjes ekonomike (emrin e pedagogut/ve që është trajtuar ndryshe nga ju në kushte të njëjta). Fakte dhe prova për të provuar “gjendjen ekonomike”.
 - Shpjegime të trajtimit të pabarabartë në raport me pedagogët e tjerë për shkak të gjendjes arsimore (emrin e pedagogut/ve që është trajtuar ndryshe nga ju në kushte të njëjta). Fakte dhe prova për të provuar “gjendjen arsimore”.

⁴ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

- Shpjegime të trajtimit të pabarabartë në raport me pedagogët e tjerë për shkak të gjendjes shoqërore (emrin e pedagogut/ve që është trajtuar ndryshe nga ju në kushte të njëjta). Fakte dhe prova për të provuar “gjendjen shoqërore”.
- Shpjegime lidhur me pretendimin për trajtim të pabarabartë në pagë për shkak të gjinisë (emrin e pedagogut/ve që është trajtuar ndryshe nga ju në kushte të njëjta).
- Shpjegime, fakte dhe prova për të identifikuar shkakun “çdo shkak tjetër”.
- Informacion nëse është ankuar dhe në institucione të tjera (MASR, ASCAL, Inspektoriat i Punës apo gjykatë) lidhur me parregullsitë e vërejtura (kushtet e punës, pagën, mosrespektimin e kontratës së punës) në SHLUP Marin Barleti dhe përgjigjet e marra nga këto institucione.

Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, subjekti ankues me shkresën datë 10.08.2020, të administruar pranë KMD-së me nr. 1151, datë 12.08.2020, ka dhënë parashtrimet e saj, të shpjeguara më sipër.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1116/3, datë 14.08.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Universiteti Marin Barleti për ankesën e bërë nga D.P dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Kopje të plotë të procedurës së emërimit dhe të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me D.P dhe kopje të kontratës së punës.
 - Shpjegime lidhur me procedurën që përdoret për shpërndarjen e ngarkesës mësimore dhe administrative të stafit akademik me gradën shkencore, PhD dhe në veçanti të stafit të Departamentit të Drejtësisë për vitin akademik 2019-2020.
 - Shpjegime lidhur me procedurën që përdoret për shpërndarjen e lëndëve mësimore dhe pretendimeve të ankueses për këtë rast.
 - Shpjegime, fakte dhe prova lidhur me pretendimin e subjektit ankueses për trajtim të pabarabartë në pagë dhe shpërblime për shkak të gjinisë.

Me shkresën nr. 46, datë 28.08.2020, Universiteti Marin Barleti, në mes të tjerash informoi se: *“D.P është punësuar në datë 10.09.2018, si pjesë e stafit akademik, pranë Departamentit të Drejtësisë, si dhe njëkohësisht koordinatorë akademike e programeve profesionale. D.P, si pedagoge e Departamentit të Drejtësisë, i është ngarkuar dhe shërbimi administrativ akademik mbështetës si koordinatorë e këtij Departamenti (pasqyruar me gjithë koordinuesit e tjerë me Urdhër nr. 111, datë 10.12.2019). Koordinimi në departament i është hequr si angazhim në datë 11.04.2020, gjatë periudhës së karantinës, gjë për të cilën D.P është njoftuar me e-mail (dhe ky ka qenë një lehtësim për të nga angazhimi administrativ që shkon në interes të punës kërkimore). Duhet theksuar se, në zbatim të nenit 59, të Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë në RSH” citohet si më poshtë: “Personeli akademik në institucionet e arsimit të lartë kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të institucionit të*

arsimit të lartë, këshillim për studentët si dhe veprimtari të tjera”. Proceset e punës së koordinatores akademike të departamentit nuk janë angazhime të mirëfillta në detyra funksioni administrativ por angazhim në procese pune në ndihmë e shërbim të procesit mësimor të Departamentit dhe Fakultetit, si: kontakte me studentët dhe pedagogët, ndjekjen e realizimit të mësimdhënies, plotësime të tij sipas kriterëve akademike, etj, detyra këto të pashkëputura nga procesi mësimor dhe ai kërkimor, sikurse citohet në Pikën 3 të kontratës së punës. D.P ka dërguar e-mail në datë 29.06.2020, duke bërë me dije që do të dorëhiqet nga kontrata që ka me institucionin, duke dorëzuar çelësin e zyrës dhe kartën elektronike tek një nga punonjësit e zyrës së fotokopjes. Më pas në datë 01.07.2020, është përcjellë me postë dorëheqja me shkrim nga D.P. Dorëheqja është pranuar nga Rektori dhe i është përcjellë për veprime të mëtejshme Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Zyrës së Financës. Po në atë datë D.P i është mbyllur adresa e e-mail-it, duke qenë se ka dhënë dorëheqjen dhe duke pasur parasysh që adresa e-mail është adresë zyrtare komunikimi në përdorim vetëm nga stafi i institucionit. Pretendimi i D.P që me mbylljen e adresës së e-mail-it nuk ka mundur të japë mësim, nuk ka bazë ligjore, pasi në momentin që dorëhiqesh në mënyrë të menjëhershme, nuk mund të ushtrosh më asnjë detyrë. Në përbërje të Departamentit ku ka bërë pjesë dhe D.P, kanë qenë 7 anëtarë, 4 femra dhe 3 meshkuj, me grada shkencore dhe tituj akademik si më poshtë: Prof.Asoc.Dr. B.Y dhe E.S, titull Dr. E.B, J.B, A.H dhe ankuesja dhe me titull Msc. E.Z. Pretendimi i ankueses lidhur me mbingarkesën krahasuar me anëtarët e tjerë të departamentit me gradën PhD, nuk qëndron pasi: Prof.Asoc.Dr. B.Y është Përgjegjës i Departamentit. Dr. E.B, ka njëkohësisht angazhim në mësimdhënie dhe si Koordinatore Akademike e Departamentit të Drejtësisë (angazhim i mbajtur më parë nga D.P). Dr. A.H ka njëkohësisht angazhim në mësimdhënie dhe në projekte kërkimore shkencore, në institutet pjesë mbështetëse të institutit të studimeve e projekteve AIPA. Dr. J.B ka njëkohësisht angazhim në mësimdhënie dhe në proceset e vlerësimit të performancës të stafit akademik dhe administrativ, duke u angazhuar në koordinimin total të këtij procesi. Kështu që pretendimi i ankueses bie poshtë, përkundrazi, mund të përmendim që pozicionet e përmendura kanë ngarkesë akoma më të madhe se koordinatore akademike, pasi të tre këto anëtare përfshihen dhe në procese të tjera të Departamentit. Pretendimi i ankueses lidhur me diskriminimin gjinor, nuk qëndron, pasi vetë përbërja gjinore e Departamentit nuk lë vend për dyshime për diskriminim gjinor, kur shumica e pjesëtarëve përbëhet nga femra. Pretendimi i ankueses për diferencim në pagë për shkak të gjinisë është plotësisht i pabazë dhe nuk qëndron, pasi si parim paga është një çështje që negociohet mes punëdhënësit dhe punëmarrësit, por sqarohet se, politika e pagave në institucion bazohet në gradën shkencore, vjetërsinë e punës dhe eksperiencën e pedagogëve. Për pedagogët me gradën Dr. kufiri i pagës varion mes 90.000-130.000 lekë bruto. Ndërkohë D.P edhe pse me vetëm 2 vite punë e ka pasur pagën 110.000 lekë bruto. Lidhur me pretendimin se pedagogët meshkuj me gradë PhD, kanë pagë më të lartë, sqarohet se dy pedagogët meshkuj në Departament janë me gradë më të lartë shkencore (Profesor i Asociuar) dhe kanë një pagë më të lartë se D.P për shkak të gradës më të lartë shkencore dhe eksperiencës mbi 30 vjeçare në arsimin e lartë. Ndërsa pedagogu tjetër mashkull Msc E.Z ka një pagë më të ulët se ankuesja, për shkak të gradës. Pretendimi i ankueses se ka pasur “trajtimit të pabarabartë për shkak të gjendjes ekonomike” ngarkesë të madhe

administrative, nuk qëndron, pasi siç përcaktohet në nenin 59 të Ligjit 80/2015, personeli akademik kryen veprimtari të mësimdhënies, kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të institucionit, këshillim për studentët dhe veprimtari të tjera. Detyrat administrative janë pjesë e angazhimeve mbështetëse të personelit akademik, në kuadër të të qenit pjesëtar i Departamentit si njësi akademike; shumë apo pak, detyrat administrative iu jepen anëtarëve sipas nevojave të departamentit dhe angazhimeve mësimore e kërkimore, me kushtin që të mos tejkalohet numri total i orëve të punës, që është 1536 orë pune, përcaktuar në udhëzimet e MASR. Administrimi i procesit mësimor është detyrë ekskluzive e sistemit akademik, pra e Departamentit me pjesëtarët e tij, prej të cilëve përzgjidhen koordinatorët e procesit. Fillimisht D.P i është ngarkuar koordinimi i programeve profesionale, të sapo hapura në universitet, veprimtari e cila konsistonte në koordinimin e përgatitjes së një materiali promovues për prezantimin e këtyre programeve tek studentët. Duke qenë se Njësia ndihmëse e koordinimit të programeve profesionale u shkri, D.P është caktuar si Koordinatorë e Departamentit të Drejtësisë, e cila kërkonte një angazhim minimal, më pak se 1 orë/ditë dhe jo më shumë se 1-2 ditë/javë. Pretendimi i ankueses lidhur me ngarkesën e lartë akademike, nuk qëndron pasi në përputhje me Kreun III, pika 5 të Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2016 të MASR, lidhur me veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL, përcaktohet se: “Në institucionet jopublike të arsimit të lartë ngarkesa minimale përcaktohet nga vetë institucioni, ndërsa ngarkesa maksimale nuk mund të tejkalojë kohën e punës së përcaktuar në Kodin e Punës”. Në Universitetin “Barleti”, ngarkesa akademike shpërndahet çdo fillim viti akademik sipas formimit dhe gjykimit në mbledhjet e departamentit që bëhen në bashkëpunim me pedagogët e Departamentit. Ngarkesa akademike minimale për vitin akademik 2019-2020 ka qenë e përcaktuar si 350 orë në vit. Ngarkesa ndahet me lëndë, numri i orëve totale nuk mund të jetë gjithnjë i barabartë mes kolegëve (lënda nuk jepet gjysëm, por e plotë dhe lëndët kanë volume orare të ndryshme), gjithashtu respektohet parimi i mostejkalimit të numrit total të orëve të punës. D.P ka marrë përsipër kryesisht lëndë në programin master, për shkak edhe sepse kishte gradën Dr, prandaj ngarkesa e saj, ashtu si dhe e shumë pedagogëve të tjerë, ka figuruar pak më lartë se kufiri minimal i vendosur nga institucioni. Ankuesja në ngarkesën e saj ka pasur vetëm dy lëndë të Departamentit të Drejtësisë, që i ka zgjedhur në mbledhjet e këtij Departamenti për ndarjen e ngarkesës akademike. Lëndët e tjera, ankuesja i ka marrë me dëshirën e saj, nga bisedimet që ka zhvilluar personalisht me departamentet e tjera, pa urdhër nga Departamenti ku bënte pjesë. Nga ana e drejtuesve vëmendja ka qenë që me lëndët që zgjidhte të fokusohet në një fushë të caktuar, por ka qenë këmbëngulja e ankueses për t’i mbajtur lëndët që kishte zgjedhur me pretendimin se janë të fushës së saj të specializimit. Ngarkesa mësimore e D.P për nga sasia ka qenë në përputhje me legjislacionin në fuqi, ndërsa për nga cilësia ka qenë tërësisht e zgjedhur prej saj. D.P asnjëherë nuk e ka ngritur këtë pretendim, për aq kohë sa është bërë me dëshirën dhe kërkesën e saj dhe për këtë gjë nuk rezulton asnjë ankesë me shkrim apo e-mail. Shpërblimi që pretendon D.P, që i takon punonjësit kur tejkalohet numri total i orëve të punës, në rastin konkret, nuk ka ndodhur. Bilancin total të orëve të realizuar në veprimtarinë e Departamentit: mësimore, kërkimore, administrative e bën njësia bazë, Departamenti dhe nuk ka asnjë raportim për tejkalim për D.P. Pra, nuk ka pasur asnjë

mosrespektim kontrate dhe nuk mund të ketë patur “ndikim në gjendjen e saj shoqërore e sociale”. Për më shumë D.P me kërkesë të saj, i është rritur niveli i pagës me një diferencë prej 15.000 lekë neto, duke filluar nga data 01.03.2019. Pretendimi i ankueses, lidhur me presionin për të ikur nga puna, nuk qëndron pasi, D.P është thirrur në takim për ta këshilluar, për të pasur kujdes me cilësinë e punës, pasi rrezikoi disa herë në procesin e licensimit të programit 5-vjeçar të Drejtësisë për shkak të punës së dobët. Pretendimi i ankueses për shkak të gjendjes arsimore, duke u përdorur emri i saj për të firmosur sillabuset e dërguara në MASR për licensim programi, sqarohet si më poshtë: Në aktet ligjore lidhur me licensimin e programeve, përcaktohen kërkesat dhe dokumentacioni që duhet dorëzuar nga IAL-të, në të cilat përfshihet dhe lista e stafit akademik që përfshihet në mësimdhënie, kopje e diplomave dhe dëshmime të gradave dhe titujve që vërtetojnë arsimin dhe ekspertizën konform kërkesave. Dorëzimi i dokumentacionit dhe kriteret për disa prej lëndëve, kërkojnë staf akademik me gradë shkencore Doktor. Nuk është parashikuar që titullarët e lëndëve (ata që hartojnë syllabusin) të japin mësim të gjitha ato lëndë. Për hartimin e syllabusit ngarkohen disa njerëz, me gradë shkencore, në kuadrin e shërbimeve akademike ndaj procesit të mësimdhënies dhe zbatimi bëhet duke shpërndarë ngarkesën, sipas personelit dhe angazhimeve të tjera në Departament. Pretendimi i ankueses për tu dëmshpërblyer financiarisht me 7 paga nuk qëndron, pasi ankuesja është dorëhequr me dëshirën e saj, pa respektuar asnjë procedurë apo afat njoftimi, pa bërë dorëzimin e detyrës dhe dokumentacionit”.

- Në vijim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shkresën nr. 1116/5, datë 07.10.2020, ka kërkuar nga Universiteti Marin Barleti informacion shtesë dhe kopje të dokumentacionit si më poshtë:
 - Kopje të plotë të procedurës së emërimit të D.P (shpallja e vendit të punës, intervista, urdhri i emërimit, etj).
 - Kopje të planifikimit të shpërndarjes së lëndëve dhe ngarkesës mësimore për të gjithë pedagogët e Departamentit të Drejtësisë për vitin akademik 2019-2020 (procesverbalin e mbledhjes, tabelën e shpërndarjes së lëndëve dhe ngarkesës mësimore).
 - Kopje të realizimit të ngarkesës mësimore për vitin akademik 2019-2020, për të gjithë pedagogët e Departamentit të Drejtësisë.
 - Informacion të ngarkesës mësimore dhe të pagës, për pedagogët: E.M, koordinator i Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional dhe H.O, koordinator i Departamentit Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit.
 - Informacion lidhur me pretendimin se në datë 24.06.2020 ka zhvilluar takim me Administratorin e deleguar dhe i është bërë presion për të dhënë dorëheqjen (kopje të procesverbalit të takimit).
 - Informacion lidhur me pedagogët që kanë kërkuar dorëheqjen gjatë muajve: qershor, korrik dhe shtator 2020 (nëse ka, të ndarë sipas gradës shkencore).
 - Informacion lidhur me e-mail-in datë 26.06.2020 të dërguar nga ankuesja, me anë të të cilit ka kërkuar shpërblym për ngarkesën në punë, por që nuk ka marrë përgjigje.

- Informacion të shpërblimeve të dhëna nga universiteti gjatë vitit akademik 2019-2020.
- Shpjegime dhe fakte lidhur me pretendimin se: *“Kur universitetet kanë për të akredituar programin, punësojnë staf me grada dhe tituj dhe më pas kur marrin akreditimin, lëndët i japin pedagogë me titull MSc, pavarësisht formimit dhe profilizimit të pedagogëve”*. Lidhur me këtë, në programin 3-vjeçar në drejtësi, vitin e kaluar i është përdorur emri duke qenë titullare e disa syllabuseve për në ministri, dhe më pas këto lëndë i janë dhënë që ti zhvillojnë, kolegë të departamentit të drejtësisë dhe departamenteve të tjera me MSc, si psh lëndët: E drejta e punës; Histori e institucioneve politiko-juridike; E drejta familjare; E drejta financiare; Shkrimi dhe arsyetimi ligjor.
- Kopje të dokumentit të politikave të pagave në universitet, dhe fakte lidhur me pretendimin se: *“Ankuesja nuk paguhet njësoj si kolegët meshkuj që kanë gradën shkencore PhD”*.
- Kopje të plotë të Rregullores Akadematike të universitetit.
- Kopje të formularit të vetëdeklarimit vjetor të D.P, për vitin akademik 2018-2019 dhe 2019-2020.
- Kopje të skedës së vlerësimit të performancës së D.P, për vitin akademik 2018-2019 dhe 2019-2020.

Me shkresën nr. 46/1, datë 14.10.2020, Universiteti Marin Barleti, në mes të tjerash informoi se: *“Lidhur me planifikimin e shpërndarjes së lëndëve dhe ngarkesës mësimore për pedagogët e drejtësisë, sqarohet se anëtarët e departamentit kanë kontrata të ndryshme të cilat rrjedhin nga grada shkencore, nga detyrat administrative apo kërkimore shkencore. Kështu, përgjegjësit e departamenteve e kanë ngarkesën minimale 300 orë, lektorët me gradën, Prof. kanë ngarkesën minimale 300 orë, lektorët me gradën Dr. dhe Msc. kanë ngarkesën minimale 360 orë, ndërkohë që stafi i angazhuar në projekte dhe kërkim shkencor ka ngarkesën minimale 200 orë. Të gjitha sa më sipër evidentohen në kontratë në formë përqindjesh dhe orësh. Në ngarkesën mësimore të parashikuar për D.P, Departamenti i Drejtësisë ka parashikuar një ngarkesë totale prej 320 orësh, por ankuesja ka negociuar me Departamentin e Edukimit për marrjen e një lënde nga ky program, pa dijeninë e Departamentit të Drejtësisë. Megjithatë ka qenë koordinatori institucional i ngarkesës që me kërkesën e D.P dhe Departamentit të Edukimit e ka reflektuar këtë lëndë në ngarkesën e përgjithshme të pedagoges. Me fillimin e karantinës dhe leksioneve on line, shumë pedagogë të jashtëm u larguan dhe ngarkesa e tyre u mor përsipër nga pedagogët e brendshëm. Një prej këtyre lëndëve (Sigurimet Shoqërore) e mori përsipër D.P. Në lidhje me kërkesën për realizimin e ngarkesës së pedagogëve për këtë vit akademik, sqarohet se viti akademik 2019-2020 nuk është mbyllur, pasi vijojnë seancat e përsëritjeve për rikuperimin e orëve on line, provimet dhe riprovimet. Viti akademik për programet bachelor mbyllet në 2 nëntor, në momentin kur fillon edhe viti i ri akademik, ndërsa për programet master mbyllet në datë 18 nëntor. Në këto kushte nuk është bërë ende një analizë lidhur me realizimet individuale të pedagogëve. Lidhur me ngarkesën mësimore dhe pagën e pedagogëve E.M dhe H.O*

informohet se: E.M paga 50.000 lekë bruto dhe ngarkesa 260 orë mësimore, pa llogaritur orët e trajnimeve që realizon si Menaxher i Barleti Training and Testing Center; H.O paga 50.000 lekë bruto dhe ngarkesa 427 orë mësimore. Gjatë periudhës qershor-shtator 2020, informohet se kanë kërkuar dorëheqjen 3 pedagogë, për arsye personale: J.K, S.S dhe E.M. Lidhur me kërkesën e D.P të datës 26.06.2020 në të cilën ka kërkuar shpërblim për ngarkesën në punë, informohet se, D.P është larguar me kërkesën e saj, pa respektuar afatin, procedurën e njoftimit, pa bërë dorëzimin e detyrës dhe dokumentacionit, pa njoftuar Përgjegjësën e Departamentit apo drejtuesit e tjerë duke i shkaktuar institucionit anomali dhe kosto shtesë. Për sa më lart pretendimi i ankueses për shpërblim nuk qëndron dhe konform nenit 156 të Kodit të Punës të RSH-së, veprimi konsiderohet “Braktisje e vendit të punës”. Universiteti Marin Barleti gjatë vitit akademik 2019-2020, nuk ka akorduar shpërblime shtesë për asnjë punonjës. Lidhur me pretendimin e përdorimit të emrit në sillabuse gjatë akreditimit, sqarohet se: Procesi i hartimit të sillabuseve për një program studimi realizohet në momentin kur aplikohet në Ministrinë përgjegjëse për arsimin për licensimin e programit. Programi Bachelor në Drejtësi është licensuar në vitin 2013 dhe nuk ka pasur më nevojë për hartim të sillabuseve. Përpara çdo viti akademik, pedagogu i lëndës (i cili mund të ndryshojë nga viti në vit dhe të mos jetë detyrimisht pedagogu që ka hartuar së pari sillabusin që në vitin 2013) ka detyrën akademike që të rishikojë sillabusin ekzistues dhe të përditësojë literaturën dhe temat deri në masën 20%. Në momentin që pedagogu e realizon këtë, bën dhe nënshkrimin e sillabusit. Mësimdhënia në programin Bachelor 3-vjeçar, nuk kërkon detyrimisht gradën Doktor, pasi ligji i arsimit të lartë, parashikon që pedagogu duhet të jetë të paktën një nivel më të lartë se programi në të cilin angazhohet, prandaj angazhimi i pedagogëve me gradën Msc në programin bachelor, është në përputhje me ligjin e arsimit të lartë”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 85, datë 30.07.2020, Komisioneri me shkresën nr. 1482, datë 29.10.2020 njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 18.11.2020.

Seanca u zhvillua me praninë e palëve në proces: subjektit ankues, D.P dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësuesit me autorizim⁵ E.Z të Universitetit Marin Barleti.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Subjekti ankues, lidhur me trajtimin e pabarabartë në pagë, theksoi faktin⁶ se tre kolege të saja: E.B, J.B dhe A.H paguhen më shumë se ajo, pavarësisht se janë me titull akademik të njëjtë por

⁵ Me shkresën, datë 18.11.2020.

⁶ Referuar deklarimeve gjatë seancës dëgjimore, min 36.45.

ankuesja ka një ngarkesë më të madhe akademike dhe administrative. Gjithashtu ankuesja informoi⁷ se gjatë vitit akademik 2018-2019 nuk është hapur programi, “E drejtë biznesi”, kjo ka qenë arsyeja që përveç ngarkesës në departamentin e saj ka marrë ngarkesë dhe tek departamentet që lidheshin me profilin e saj, në ciklin bachelor, gjë e cila ka bërë që ngarkesa e saj të jetë më e lartë. Në përfundim, ankuesja deklaroi⁸ se ngarkesa e saj mësimore ka qenë 502 orë.

Përfaqësuesi i Universitetit Marin Barleti, deklaroi se pretendimet e ankueses nuk qëndrojnë, pasi:

- institucioni ka tabelën e kategorizimit të pagave, që për kategorinë lektor varion nga 100.000 – 130.000 lekë, dhe ankuesja ka qenë e vlerësuar në mesin e kësaj vlere, por masa e pagës i mbetet për vlerësim institucionit dhe vjetërsisë në punë;
- ka pedagogë meshkuj, si H.O dhe E.K, që kanë pagë më të ulët se ankuesja, por në vijim do sjellim informacion për pagat e pedagogëve të tjerë që janë në kushte të njëjta dhe të ngjashme me ankuesen, gjithashtu pedagogja femër, J.B paguhet 130.000 lekë dhe ka eksepriencë pune 7 vjet.

Në përfundim të seancës dëgjimore, nga ana e institucionit të Komisionerit u la si detyrë palëve si më poshtë: ankuesja të dërgonte informacion dhe dokumentacion lidhur me emrin e pedagogut/ëve i cili ishte në kushte të njëjta apo të ngjashme me të, por që kishte pagë më të lartë, - kopje të përgjigjes të Inspektoriatit të Punës, drejtuar ankueses; - dhe kërkesën e dorëheqjes së ankueses, ndërsa Universiteti Marin Barleti të dërgonte informacion dhe dokumentacion lidhur me: - emrin e pedagogut/ëve të cilët ishin në kushte të njëjta apo të ngjashme me ankuesen por që kishte pagë të ndryshme dhe realizimin e ngarkesës mësimore të Departamentit Juridik të vitit akademik 2019-2020.

Në vijim të procedurës, D.P me e-mail-in datë 19.11.2020 ka dërguar dokumentacionin e kërkuar dhe ka informuar se: *“Në muajin Korrik 2019 për arsye se “Njësia e programeve të studimit dhe marrëdhënieve me komunitetin” u suprimua, ajo kaloi si pjesë e Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional. Kjo ishte dhe arsyeja që i është dhënë lënda “Politikat dhe ligjshmëria në arsim”. Më pas në muajin shtator, ka kaluar si koordinator e Departamentit të Drejtësisë, duke u bërë pjesë e këtij departamenti. Detyrën e koordinatorës së Departamentit të Drejtësisë e ka pasur paralel dhe me detyrën e koordinatorës së programeve me karakter profesional, prandaj ka pasur dhe ngarkesë më të madhe administrative krahasuar me koleget e tjerë”*. Lidhur me pretendimin se trajtohej më mënyrë të pabarabartë në pagë për shkak të gjinisë, ankuesja nuk dërgoi informacion lidhur me emrin e pedagogut i cili ishte në kushte të njëjta apo të ngjashme me të, por që kishte me pagë më të lartë.

⁷ Referuar deklarimeve gjatë seancës dëgjimore, min 01.12.01.

⁸ Referuar deklarimeve gjatë seancës dëgjimore, min 49.20.

Në vijim të procedurës, Universiteti Marin Barleti me e-mail-in datë 26.11.2020 dhe 10.02.2021 ka dërguar dokumentacionin e kërkuar dhe ka informuar se: *“Lidhur me kërkesën për të paraqitur një pedagog të universitetit, i cili mban gradë shkencore Dr, ka ngarkesë të plotë akademike me të paktën 360 orë mësimore dhe ka funksionin e koordinatorit për ta krahasuar me ankuesen, ju informojmë se pedagogu E.M është në pozicionin e koordinatorit për programet master në ekonomi dhe ka pagën 80.000 lekë në muaj, pedagogia E.F ka detyrën e koordinatores në programin e studimit në psikologji dhe ka pagën 100.000 lekë bruto dhe pedagogia O.L e cila mbulon detyrën e shefes së Departamentit të Arkitekturës dhe pedagoges me ngarkesë të plotë akademike, ka pagën 100.000 lekë”.*

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i është ofruar mundësia që të japë shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga ankuesja.

Sa i përket pretendimeve të ankueses, lidhur me diferencimin në pagë, Komisioneri për efekt të afateve ligjore të pranimit të ankesës do të shqyrtojë ngarkesën mësimore për vitin akademik 2019-2020.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës dhe në analizë të sa më sipër, rezultoi se:

D.P në datë 10.09.2018 është punësuar si pjesë e stafit akademik, pranë Universitetit Marin Barleti. Në datë 10.02.2019 mes palëve është lidhur Kontrata Individuale e Punës me afat të pacaktuar. Referuar informacionit të dërguar nga universiteti, ankuesja pas datës 01.03.2019, ka pasur pagën në vlerën e 115.000 lekë bruto.

Ankuesja me Vendimin nr. 73, datë 07.10.2019 “*Mbi organizimin e veprimtarisë së programeve të studimit me karakter profesional në SHLUJ “Universiteti Marin Barleti”*” është caktuar në rolin e Koordinatorës Institucionale për ndjekjen e ecurisë së programeve të studimit me karakter profesional.

D.P me Urdhërin e Brendshëm nr. 111, datë 20.12.2019 “*Për saktësimin e listës së koordinatorëve në SHLUJ “Universiteti Marin Barleti”, për vitin akademik 2019-2020*” është ngarkuar me detyrën e koordinatorës së Departamentit të Drejtësisë.

Me e-mailin datë 11.04.2020, të Rektorit të Universitetit Marin Barleti, D.P është liruar nga detyra e koordinatorës së Departamentit të Drejtësisë dhe është zëvendësuar nga E.B.

Ankuesja me e-mail-in datë 29.06.2020 dhe shkresën datë 01.07.2020, drejtuar Universitetit Marin Barleti ka shprehur dëshirën e saj për të mos qenë më pjesë e SHLUJ “Univeriteti Marin Barleti”, duke dhënë dorëheqjen e menjëhershme.

a) Lidhur me trajtimin e pafavorshëm dhe të pabarabartë, sa i përket trajtimit me pagë sipas ngarkesës mësimore.

Në nenin 59 të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se: “*Kategoritë e personelit akademik. 1. Personeli akademik në institucionet e arsimit të lartë kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të institucionit të arsimit të lartë, këshillim për studentët si dhe veprimtari të tjera. 7. Raportet ndërmjet veprimtarive të ndryshme për personelin akademik, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, përcaktohen nga institucioni i arsimit të lartë. 8. Ngarkesa e plotë mësimore për personelin akademik në institucionet publike të arsimit të lartë përcaktohet nga institucioni, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Në institucionet jopublike ngarkesa minimale përcaktohet nga vetë institucioni”.*

Në Udhëzimin nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL”, përcaktohet se: “*Neni 3. Veprimtaritë që kryen personeli akademik në IAL janë: a) mësimdhënie; b) kërkimi shkencor ose artistik; c) kontribut institucional; d) kontribut*

profesional”, ndërsa në Kreun II, përcaktohet ngarkesa mësimore vjetore për personelin akademik me kohë të plotë në auditor, e cila është: “*b) Kategoria Lektorë 165 orë në auditor*”. Në Kreun III. Dispozita të fundit përcaktohet se: “*1. Çdo anëtar i personelit akademik i punësuar me kohë të plotë në IAL duhet të përmbushë detyrimet për kohën vjetore të punës prej 1536 orë*”, ndërsa në pikën 5 përcaktohet se: “*Në institucionet jopublike të arsimit të lartë ngarkesa minimale përcaktohet nga vetë institucioni, ndërsa ngarkesa maksimale nuk mund të tejkalojë kohën e punës së përcaktuar në Kodin e Punës*”.

Në nenin 7 të Kontratës Individuale të Punës të D.P, parashikohet se: “*7.2. Veprimtaritë në të cilat angazhohet punëmarrësi gjatë kohës së punës janë: a. Mësimdhënie; b. Kërkim, zhvillim, projekte, inovacion; c. Mbështetje për institucionin dhe promovim institucional*”.

Në nenin 52 të Statutit të SHLUJ “Universiteti Marin Barleti”, në detyrat e Përgjegjës të Departamentit, parashikohet se: “*Përgjegjësi i Departamentit bën analizën e punës mësimore dhe kërkimore të departamentit dhe propozon ose merr masa për përmirësimin e mëtejshëm të saj; ndjek dhe përgjigjet për veprimtarinë mësimore dhe kërkimore të departamentit*”.

Në nenin 10/10 të Rregullores Akademike të SHLUJ “Universiteti Marin Barleti”, në detyrat e Përgjegjës të Departamentit, parashikohet se: “*Kryen shpërndarjen e ngarkesës mësimore dhe asaj kërkimore të Departamentit*”.

Referuar legjislacionit të sipërcituar, rezulton që një pedagog i brendshëm, përveç mësimdhënies mund të ngarkohet dhe me detyra të tjera në mbështetje të institucionit. Referuar informacionit të vënë në dispozicion nga palët, rezulton se me Urdhërin e Brendshëm nr. 111, datë 20.12.2019 janë ngarkuar me detyrën e koordinatorëve të departamenteve të ndryshme të universitetit dhe 9 pedagogë të tjerë, nga të cilët dy pedagogë janë meshkuj: EM dhe H.O, dhe tetë pedagoge janë femra.

Referuar kontratës së punës së ankueses por dhe dokumentacionit të depozituar nga palët në proces, nuk rezulton që ankuesja të jetë ankuar apo të ketë ngritur shqetësime lidhur ngarkimin e detyrave si koordinator e programeve të masterit profesional apo koordinator e departamentit të drejtësisë, deri disa ditë përpara se të jepte dorëheqjen, kur me e-mail-in datë 25.06.2020 i është drejtuar, Rektorit dhe Përgjegjës të Departamentit, në të cilin mes të tjerash ka kërkuar dëmshpërblim për tejkallim ngarkese.

Referuar të dhënave të deklaruara nga Universiteti Marin Barleti me shkresën nr. 46/1, datë 14.10.2020, lidhur me ngarkesën mësimore për vitin akademik 2019-2020, rezulton që pedagogët me gradën shkencore Dr. dhe Msc. kanë ngarkesën minimale 360 orë.

Lidhur me ngarkesën mësimore të parashikuar dhe të realizuar për vitin akademik 2019-2020 të pedagogëve të Departamentit të Drejtësisë, Komisioneri disponon dy dokumente të vëna në dispozicion nga palët.

Në tabelën e shpërndarjes së ngarkesës – viti akademik 2019-2020 të dërguar nga ankuesja, me e-mail-in, datë 19.11.2020, rezulton se në emër të pedagoges D.P është parashikuar ngarkesa mësimore prej 502 orësh.

Lenda (Bachelor / Master, Program Profesional)	Ngarkesa Sem. I		Ngarkesa Sem. II		Totali
	L	S+D	L	S+D	
MSH Dr. Tregtare - Legjislacioni evropian i konkurrencës 45L+30S	45	30			502
BA Drejtësi - Profili E Dr. Biznesi - E drejta e Konkurrencës DKO 412/6 ECTS / 30L+30S / Viti III (Seminaret A.....)	12				
MP MNX - Politikat dhe Ligjshmëria në Arsim ose Drejtimi dhe Menaxhimi i Institucionit të Arsimit (40L +30S)	40	30			
MSH PEAP - Zgjerimet e Bashkimit Evropian/ ose Aktorët e Politikëbërjes në BE 30L+10S Viti II Sem II + Viti I Sem II			30	10	
BA MPMP - E drejta Biznesi - 30L+30S / Viti I	30	30			
BA FBS Sigurimet Shoqërore			30	30	
MP LMBNJ - E Drejta Sociale 30L+20S			30	20	
MSH PEAP - Histori e Integritimit Evropian 40L+20S	40	20			
MSH Dr. Tregtare - E drejta private evropiane 45L+30S			45	30	

Në tabelën e parashikimit dhe realizimit të ngarkesës akademike 2019-2020 të dërguar nga Universiteti Marin Barleti, me e-mail-in datë 26.11.2020, rezulton se në emër të pedagoges D.P, është parashikuar ngarkesa mësimore prej 390 orësh, (por nuk figurojnë të jenë parashikuar lëndët: Sigurimet Shoqërore, Zgjerimet e Bashkimit Evropian dhe E drejta e konkurrencës) dhe realizimi prej 381 orësh.

Lëndët (Bachelor/Master, Program Profesional)	Ngarkesa Sem I				Ngarkesa Sem II				Parashikuar	Realizuar
	Leksion		Seminar		Leksion		Seminar			
	P	R	P	R	P	R	P	R		
Mastershkencor Dr. Tregtare - Legjislacioni evropian i konkurrencës	45	33	30	16					390	381
Master profesional ne Lidership LMBNJ - E Drejta Sociale					30	26	20	20		
Bachelor në Marketing - E drejta Biznesi	30	30	30	30						
Bachelor Financë - Kontabilitet - Bankë - Sigurimet shoqërore					0	23	0	20		
MSH PEAP - Zgjerimet e Bashkimit Evropian/ ose Aktorët e Politikëbërjes në BE 30L+10S					0	16	0	8		
master shkencor studime evropiane - Histori e Integritimit Evropian	40	33	20	15						

Master Shkencor Dr. Tregtare - E drejta private evropiane					45	36	30	24		
Master Profesional në Edukim- Politikat dhe Ligjshmëria në Arsim	40	33	30	18						

Në përshkrimin e realizimit të ngarkesës mësimore, Departamenti Juridik përshkruan se: Pedagogia D.P ka lënë pa përfunduar 3 javët e fundit të leksioneve master të semestrit të dytë si dhe nuk ka përmbyllur asnjë nga provimet e semestrit të dytë apo riprovimet.

Në analizë të përbërjes së Departamentit të Drejtësisë, lidhur me ngarkesën mësimore të realizuar dhe të gjinisë së tyre rezultojnë se në përbërje të Departamentit janë 7 anëtarë, (4 femra dhe 3 meshkuj, përfshirë ankuesen), me grada shkencore dhe me ngarkesë mësimore të realizuar si më poshtë:

1. Prof.Asoc.Dr. B.Y, me detyrë Përgjegjës i Departamentit i cili nuk ka pasur një ngarkesë mësimore të plotë për shkak se ka zëvendësuar në Semestrin e dytë Dr. I.P, me ngarkesë mësimore të realizuar 177 orë.
2. Prof.Asoc.Dr. E.S, me detyrë pedagog, me ngarkesë mësimore të realizuar 402 orë.
3. Dr. J.B me detyrë pedagoge dhe e angazhuar në proceset e vlerësimit të performancës së stafit, me ngarkesë mësimore të realizuar 450 orë dhe me pagë 130.000 lekë.
4. Dr. D.P me detyrë pedagoge dhe Koordinatorë Institucionale për programet e studimit me karakter profesional, me ngarkesë mësimore të realizuar 381 orë dhe me pagë 115.000 lekë.
5. Dr. E.B me detyrë pedagoge, me ngarkesë mësimore të realizuar 328 orë, e cila pas datës 11.04.2020 është ngarkuar dhe me detyrën e koordinatores së departamentit.
6. Dr. A.H me detyrë pedagoge, me ngarkesë mësimore të realizuar 61 orë, e cila ka realizuar vetëm një lëndë për shkaqe shëndetësore dhe më pas me leje lindje.
7. Msc. E.Z me detyrë pedagog, me ngarkesë mësimore të realizuar 254 orë.

Në analizë të informacionit të sipërcituar, konstatohet se pedagogët meshkuj: B.Y, E.S dhe E.Z janë me tituj të ndryshëm akademik (Prof.Asoc.Dr dhe Msc) krahasuar me ankuesen (Dr) dhe referuar Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018 *“Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”*, dhe deklarimeve të Universitetit Marin Barleti⁹, këto pedagogë kanë ngarkesë të ndryshme krahasuar me ankuesen dhe sipas tabelës së kategorizimit të pagave¹⁰, kanë dhe paga të ndryshme. Gjithashtu, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues nuk mund të krahasohet me pedagogët e tjerë të departamentit, për arsye se

⁹ Referuar shkresës nr. 46, datë 28.08.2020 të UMB: “Ngarkesa akademike minimale për vitin akademik 2019-2020 ka qenë e përcaktuar 350 orë në vit”.

¹⁰ Referuar shkresës datë 04.10.2017 “Kategorizimi dhe unifikimi i pagave” të Universitetit Marin Barleti, përcaktohet se: Kategoria e pedagogëve, Lektorë me gradë: - MSc, ka pagën 80.000-90.000 lekë, - PhD, ka pagën: 100.000-115.000-130.000 lekë, - Prof, ka pagën 130.000-140.000-150.000 lekë.

rezultojnë se nuk janë në kushte të njëjta apo të ngjashme, pasi kanë ngarkesa mësimore të ndryshme, janë brenda kufijve të kategorizimit të pagave të kategorisë “Doktor”, por janë dhe të së njëjtës gjini.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, nuk mund të krahasohet me pedagogët e tjerë të departamentit që pretendon se janë avantazhuar për shkak të gjinisë, si në ngarkesë mësimore ashtu dhe në pagë, pasi nuk është në kushte të njëjta apo të ngjashme me ta.

Pra, vetë ankuesja D.P nuk është në kushtet e titullit të njëjtë akademik, të detyrave të njëjta apo të ngarkesës mësimore të njëjtë me pedagogët e tjerë, që të mund të merrej në konsideratë, për efekt krahasimor, elementi “gjinia”.

Gjithashtu, në mungesë të identifikimit nga ankuesja të një pedagogu që ishte në kushte të njëjta apo të ngjashme me ankuesen, Komisioneri vlerësoi të dhënat e vëna në dispozicion nga Universiteti Marin Barleti, lidhur me pedagogun, Dr. E.M të Departamentit të Shkencave të Aplikuara dhe Kompiuterike, i cili mbulonte dhe pozicionin e koordinatorit për programet master në ekonomi¹¹. Sipas të dhënave të vëna në dispozicion, rezultoi se Dr. E.M është pedagog dhe mbulon detyrën e koordinatorit dhe ka ngarkesë mësimore 350 orë, dhe pagën 80.000 lekë në muaj.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, rezultoi se pedagogu E.M ka të njëjtat detyra me ankuesen, ka një ngarkesë mësimore afërsisht të ngjashme me ankuesen, por paguhet më pak se ankuesja.

Në përfundim të arsyetimit, Komisioneri konstaton se nuk evidentohet veprim diferencues nga ana e strukturave të Universitetit Marin Barleti apo të Departamentit të Drejtësisë në planifikimin e ngarkesës mësimore dhe të trajtimit në pagë për ankuesen.

b) Lidhur me trajtimin e pafavorshëm dhe të pabarabartë sa i përket shpërblimit për tejkalim të ngarkesës mësimore.

Në nenin 16.2 të Kontratës Individuale të Punës të D.P, parashikohet se: *“Nëse punëmarrësi e tejkalon ngarkesën e përcaktuar për vitin akademik përkatës, ndërkohë që ka realizuar të gjitha detyrimet për kërkim zhvillim dhe veprimtari mbështetëse, kjo pasqyrohet në vlerësimin e performancës së tij dhe merret në konsideratë në politikën e shpërblimit të institucionit”.*

Referuar të dhënave të deklaruara nga Universiteti Marin Barleti me shkresën nr. 46.1, datë 14.10.2020, lidhur me ngarkesën mësimore për vitin akademik 2019-2020, rezultoi që pedagogët me gradën shkencore Dr. dhe Msc. kanë ngarkesën minimale, 360 orë mësimore.

¹¹ Referuar Urdhërit të Brendshëm nr. 74, datë 06.11.2017 “Për caktimin e koordinatorëve të programeve të studimit Bachelor dhe Master në UMB”, z. E.M është ngarkuar me detyrën e koordinatorit në programet e studimit master në ekonomi.

Në analizë të të dhënave të vëna në dispozicion nga palët rezulton se, në Departamentin e Drejtësisë, për vitin akademik 2019-2020, shpërndarja e ngarkesës mësimore për pedagogët me gradën shkencore Doktor, është si më poshtë:

- Dr. D.P me detyrë pedagoge dhe koordinatorë e programeve me karakter profesional, ka realizuar 381 orë mësimore.
- Dr. J.B me detyrë pedagoge dhe koordinatorë e procesit të vlerësimit të performancës të stafit akademik dhe administrativ, ka realizuar 450 orë mësimore.
- Dr. E.B me detyrë pedagoge dhe koordinatorë e departamentit të drejtësisë (pas datës 11.04.2020), ka realizuar 328 orë mësimore.

Gjithashtu, dhe pedagogu që mbulon detyrën e koordinatorit të programit master në ekonomi, Dr. E.M ka ngarkesën mësimore 350 orë mësimore, po ashtu dhe pedagogu H.O që mbulon detyrën e koordinatorit të departamentit të turizmit, mikpritjes dhe rekreacionit ka ngarkesë 427 orë mësimore.

Për sa më lart, konstatohet se ka dhe pedagogë të tjerë të cilët kanë pasur ngarkesë mësimore më të madhe së ankuesja dhe nuk kanë përfituar shpërblim, referuar informacionit¹² të dhënë nga universiteti, në të cilin bëhet me dije se institucioni nuk ka akorduar shpërblime shtesë për asnjë punonjës. Pra, nga sa shihet, në dhënien e shpërblimit për tejkalim të ngarkesës mësimore, gjinia nuk ka shërbyer si kriter favorizues për meshkujt, dhe si rrjellin dhe nuk është dizavantazuar për këtë shkak.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues nuk është ekspozuar para një trajtimi të pabarabartë dhe disfavorizues nga ana e SHLUJ “Universiteti Marin Barleti”, krahasuar me pedagog të tjerë.

c) Lidhur me pretendimin e ankueses se kur universiteti ka për të akredituar programin punëson staf me grada e tituj dhe pas akreditimit lëndët i japin pedagogë me titullin MSc.

Në nenin 59/6 të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se: “Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikimin të ciklit pasardhës. Në kolegjet profesionale të larta, personeli akademik duhet të ketë fituar së paku diplomën “Master profesional”.

Universiteti Marin Barleti me shkresën nr. 2623, datë 15.05.2019, drejtuar Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë (ASCAL), ka dërguar dosjet e vlerësimit të brendshëm për procesin e akreditimit periodik të programeve të studimit, Bachelor në “Drejtësi”, Bachelor në “Psikologji” dhe akreditimit të parë të programit të integruar Master i Shkencave në “Arkitekturë” dhe programit Master Profesional në “Menaxhim i Teknologjisë së Informacionit”.

¹² Referuar pikës 8 të shkresës nr. 46/1, datë 14.10.2020 të UMB-së.

Në personelin e deklaruar nga universiteti dhe në programin e studimit për drejtësi në ciklin Bachelor rezulton dhe emri i pedagoges, D.P. Lidhur me pretendimin e përfshirjes së emrit të D.P në program syllabus-et e departamentit të drejtësisë, nuk rezulton një parashikim ligjor që të përcaktojë kushtëzimin se personi i deklaruar si titullari/pegagogu i lëndës duhet dhe ta japë atë lëndë, për më tepër që, nuk rezulton që ankuesja të ketë kundërshtuar me shkrim apo me e-mail një gjë të tillë. Bazuar në legjislacionin e sipërcituar rezulton se dhe personeli akademik me titullin Msc, është i lejuar që të japë mësim në ciklin e parë të studimeve, Bachelor.

Lidhur me këtë pretendim, Komisioneri vlerëson se ankuesja duhet ti drejtohet Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), i cili është institucioni¹³ i vetëm në Republikën e Shqipërisë, që ka objekt të veprimtarisë së tij, vlerësimin e jashtëm të cilësisë për akreditimin e parë dhe periodik të IAL-ve e të programeve të studimit që ato ofrojnë dhe kryen monitorimin, vlerësimin e cilësive akademike e të përputhshmërisë me standardet e cilësisë së institucioneve dhe programeve të ofruara prej tyre, përpara vlerësimit për akreditim të parë dhe në vijim.

d) Lidhur me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike, shoqërore dhe arsimore dhe shqetësimin psikologjik dhe moral.

Lidhur me pretendimet e mësipërme, Komisioneri në mënyrë të vazhdueshme¹⁴ ka kërkuar nga subjekti ankues që të japë shpjegime dhe informacion lidhur me lidhjen shkakësore ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur.

Subjekti ankues në informacionet e dhëna lidhur me shkaqet e diskriminimit, ka shpjeguar ndikimin që kanë pasur marrëdhëniet e punësimit në gjendjen e saj ekonomike, shoqërore, sociale dhe shqetësimin psikologjik. Pra, ankuesja ka shpjeguar pasojat që i kanë ardhur nga veprimet e punëdhënësit por nuk ka shpjeguar situatën që veprimet e punëdhënësit në dëm të saj, janë bërë për shkaqet e pretenduara nga ajo.

Sa i takon pretendimit për diskriminim për shkak “të gjendjes ekonomike”, “të gjendjes arsimore ose shoqërore” dhe shqetësimin psikologjik, me arsyetimin se ka qenë e ngarkuar me shumë detyra administrative, ngarkesë të madhe mësimore dhe nuk është paguar për orët shtesë, gjë që ka ndikuar në gjendjen e saj ekonomike, shoqërore dhe sociale, Komisioneri vlerëson se të gjitha pretendimet e mësipërme, i kanë ardhur si pasojë e detyrave administrative dhe ngarkesës mësimore, por nuk janë “shkaqe” në vetvehte diskriminimi.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk është ekspozuar para një trajtimi të pabarabartë dhe disfavorizues nga ana e SHLUJ “Universiteti Marin Barleti”, krahasuar me pedagogët e tjerë.

¹³ Referuar VKM nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e ASCAL e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”.

¹⁴ Referuar e-mail-it datë 29.07.2020, shkresës nr. 1116/2, datë 07.08.2020 dhe kërkesave gjatë seancës dëgjimore datë 18.11.2020.

Diskriminimi përkufizohet nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në nenin 12/1/c) të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7/1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se SHLUJ “Universiteti Marin Barleti”, nuk ka ndërmarrë veprime që e kanë ekspozuar subjektin ankues ndaj një trajtimi të pabarabartë apo disfavorizues.

Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se nuk kemi një trajtim të pabarabartë apo të pafavorshëm të subjektit ankues.

Në mungesë të një trajtimi të pabarabartë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e SHLUJ “Universiteti Marin Barleti”, për shkaqet e pretenduara nga ankuesja.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 3/1, neni 7/1, nenin 12/1/c, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pika 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, të shtetases D.P nga ana e Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “Universiteti Marin Barleti”, për shkak të “gjinisë”, “gjendjes ekonomike”, “gjendjes arsimore” dhe “gjendjes shoqërore”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA